



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:015927

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05693149

P.nr.221/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Erzana Hameli- Mustafa, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.B., nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par 3 pika 3.1 lidhur me par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2325-4/23 të datës 26.02.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në seancë publike, në praninë e prokurorit të shtetit Beqë Shala, të dëmtuarit M.B., mbrojtësit të viktimave E.M., dhe të akuzuarit B.B., më datë 30.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari :

B.B., nga i ati, e ëma, e vajzërisë, i lindur më datënë Prizren ku edhe tani jeton në rr “ “ nr. ... ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, me profesion berber, i gjendjes së dobët ekonomike, ne numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

Me dt. 12.12.2023, rreth orës 19:30 min, në Prizren, në rrugën “Zenun Çoçaj” nr.3, saktësisht në shtëpinë e përbashkët familjare, i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin e të dëmtuarit M.B., i cili është viktimë e ndjeshme për shkak të marrëdhënieve familjare që kanë, të njëjtin e ka baba, në atë mënyrë që pasi i pandehuri është përdorues i substancave narkotike dhe nga babai i tij kishte kërkuar para në vlerë prej 15.00 eurove, por momentin kur i dëmtuari refuzon qet’ia jep, e godet me grusht në pjesën e hundës, me ç’rast me këto veprime i shkakton lëndime trupore si: kontuzion dhe gërvishnje e hundës dhe si e tillë kualifikohet në dëmtim të lehtë trupor e shoqëruar me dëmtim të përkohshëm të

shëndetit, lëndime këto të konstatuara në akt ekspertimin mjeko-ligjor të dt. 29.01.2024 nga Dr. A.G.,.

Këso dore ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par 3 pika 3.1 lidhur me par 1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 8,9,17, 38,39 par 1 nën par 1.2, 46, par 1 nën par 1.1, 47, 48, 69,70 të KPRK-së dhe neni 185 par 3 pika 3.1 lidhur me par 1 dhe neni 364 të KRPPK-së nr. 08/L-032 (KPP), të akuzuarit shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4(katër) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat verifikimi prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

I dëmtuari M.B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest te rregullt juridike- civile.

I akuzuari OBLIGOHET që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore të paguaj shumë prej 20 euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave, të paguaj shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën, PP/II. nr. 2325-4/23 të datës 26.02.2024, ndaj të akuzuarit B.B., nga Prizreni rr “ “ nr. ..., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par 3 pika 3.1 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit fillestar Prokurori i shtetit Beqë Shala ka deklaruar se nuk e kundërshtojmë pranim e fajësisë këtu nga ana e të pandehurit sepse i njëjti paraprakisht është i njoftuar nga ana e gjykatës për natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit i cili pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin e tij në tërësi ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit i cili me vullnet të plot dhe pa presion nga askush ka pranuar fajin për veprën penale për të cilën akuzohet i cili pranim i fajësisë gjen mbështetje në provat materiale dhe personale të cilat gjenden në aktakuzë për çka i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpalli fajtor dhe ta dënoj sipas Ligjit. Gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh rrethana lehtësuese dhe ato rënduese të përshkruara si në aktakuzë.

I dëmtuari M.B., shqyrtimit fillestar ka deklaruar se të pandehurin e kam djalë, jetojmë në një shtëpi në një familje të përbashkët, kohën dhe datën kritike kemi pasur një mosmarrëveshje verbale rreth mospajtit të fjalëve lidhur me atë se i biri im më kërkonte para

gjë që unë në mungesë të kushteve materiale nuk kam mundësi, tani ka sjellje të mira, më respekton mua, më herët më ka kërkuar para por raste të rradha janë ato por pak është nervoz por shumë shpejt i kalon, dhe kërkoj nga i biri im që në të ardhmen të mos më kërkoj para dhe të mos më shqetësoj sepse edhe unë e kam gjendje të dobët materiale, jam i pa punë, njëherë dua që djali im B të filloj punën si berber siç ka punuar më herët sepse të ardhura tjera nuk kam, dua që i biri im të i shqiptohet një dënim sa më i but, nuk do të parashtroj kërkesën pasurore juridike, jetojmë bashkë në një familje, dhe e lus gjykatën që të i shqiptoj një dënim sa më i but.

Mbrojtësi i viktimave E.M., në shqyrtimit fillestar ka deklaruar se nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë e të pandehurit, mbështes në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit si dhe deklaratën e palës së dëmtuar.

I akuzuari B.B., ka deklaruar se : e pranon fajësinë vullnetarisht për veprën penale për të cilën jam i ngarkuar si në aktakuzë dua të theksoj se jam penduar thellë për një veprim të tillë, ngase në momentin kritik kam qenë pak nervoz dhe premtoj dhe zotohem se në të ardhmen më kurrë nuk do të përsërisë veprime të tilla, i kërkoj falje babait tim këtu prezent në seancë, premtoj dhe zotohem se në të ardhmen më kurrë nuk do të përsërisë ndonjë veprim të tillë kundërligjor, do të i respektoj prindërit e mijë dhe do të i nderoj, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, jam i pa punë, i gjendjes së dobët materiale, jam mbajtësi i vetëm i familjes, e lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të but.

Në shqyrtimin fillestar, gjykata pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, në këtë aspekt, i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pranimin e fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe provat të cilat i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose faktike .

Gjyqtari i vetëm gjykues në shqyrtimin fillestar pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit i ka njoftuar palët mbi seancën mbi dënimin konform nenit 356 të KPPRK-së, të njëjtit kanë deklaruar se heqin dorë nga seanca e veçantë mbi dënimin, kështu që gjykata ka proceduar me shpalljen e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike me dt. 12.12.2023, rreth orës 19:30 min, në Prizren, në rrugën “.....” nr.3, saktësisht në shtëpinë e përbashkët familjare, i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin e të dëmtuarit M., B., i cili është viktimë e ndjeshme për shkak të marrëdhënieve familjare që kanë, të njëjtin e ka baba, në atë mënyrë që pasi i pandehuri është përdorues i substancave narkotike dhe nga babai i tij kishte kërkuar para në vlerë prej 15.00 eurove, por momentin kur i dëmtuari refuzon qet’ia jep, e godet me grusht në pjesën e hundës, me ç’rast me këto veprime i shkakton lëndime trupore si: kontuzion dhe gërvishtje e hundës dhe si e tillë kualifikohet në dëmtim të lehtë trupor e shoqëruar me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, lëndime këto të konstatuara në akt ekspertimin mjeko-ligjor të dt. 29.01.2024 nga Dr. A.G.,.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare, gjykata komform nenit 251 të KPPRK-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme sipas ligjit.

Kështu, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së dhe faktet që përmban aktakuza, dhe se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par 3 pika 3.1 lidhur me par 1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës, për këtë gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese për të akuzuarin B.B., gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, rrethanën personale të akuzuarit se është mbajtësi i vetëm i familjes, kërkim faljen, pendimin dhe keqardhjen . Ndërsa, si rrethanë rënduese gjykata ka marrë mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale i njëjti ka kryer veprën kundër jetës dhe trupit . Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitive të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i dënimit, që i akuzuari në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla të kundërligjshme dhe se ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës, është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i ka i akuzuari.

Vendimi mbi për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 462 par.1 e 2 të KPP-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale u mor në kuptim të nenit 449 dhe 452 par. 1. të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 36 par. 3 pika 3.1 të Ligjit nr.08/L-109.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitive të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2024:015927, 30.04.2024

B. Profesional
Erzana Hameli- Mustafa

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gani Kastrati

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.